

## **LIRIA E SHPREHJES APO DINJITETI I NJERIUT? REFLEKTIME MBI NISMËN LEGJISLATIVE PËR DEPENALIZIMIN E FYERJES PËR GAZETARËT**

Lorenc STOJANI, LL.M\*

### **Abstrakt:**

*Punimi trajton një nga nismat e fundit në legjislacionin penal shqiptar, e cila përbën jo vetëm një çështje ligjore, në aspektin penalo-kushtetues, por edhe një temë sa aktuale aq edhe sociale në këtë tranzicion të prirur drejt shoqërisë së hapur, por të ndërthurur me një traditë dhe mentalitet ende konservator, si dhe me një individ ende jo të mbrojtur sa duhet nga një drejtësi gjithashtu në tranzicion. Në këtë kontekst, punimi, në mbrojtje të një qytetari të pafuqishëm përballë monopolit të fuqishëm mediatik, dhe në respektim paralel të lirisë së shprehjes, hedh një këndvështrim të ri të zgjidhjes së konfliktit të këtyre dy të drejtave themelore brenda vetë kodit penal; pra, edhe pa u depenalizuar fyerja për gazetarët, liria e shprehjes mund të sigurohej brenda vetë kodit penal, sepse kështu sigurohej mbrojtja e nderit të qytetarit përballë abuzimit të një media “ende patriarkale”, e cila tashmë me këtë projektligj do jetë e çliruar nga ndëshkimi penal përballë çfarëdolloj fyerje pa kriter.*

*Nga ana tjetër, pa nënvlerësuar rëndësinë e lirisë së shprehjes, në funksion të demokracisë dhe në mbrojtje të saj, punimi arrin të argumentojë, po brenda kodit penal, justifikimin e medias edhe për raste të informacioneve të pavërteta, por të bëra në mirëbesim dhe për çështje të interesit publik.*

*Në përjasje të praktikës së Gjykatës së Strasburgut, punimi sugjeron dhe ndryshime interesante në kodin penal, duke e bërë atë jo vetëm bashkëkohor, por edhe efektiv në realitetin aktual shqiptar.*

**Fjalët kyç:** *Liria e shprehjes, dinjiteti i njeriut, depenalizimi i fyerjes për gazetarët, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.*

## Hyrje

Punimi bën një oponencë të relacionit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, relacion i cili i është bashkangjitur propozimit<sup>1</sup> për disa ndryshime në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht lidhur me shfuqizimin e neneve 119 dhe 120 për fyerjen dhe shpifjen dhe disa neneve të tjera që lidhen me to. Relacioni i argumenton këto shfuqizime si një paketë masash, që synon përforcimin e garancive ligjore për ushtrimin e fjalës së lirë në Shqipëri dhe në vijim shton se, “Për një demokraci politike efektive dhe respektimin e të drejtave të njeriut, liria e shprehjes nuk mbart rëndësi vetëm në vetvete, por, gjithashtu, ajo luan një rol kryesor në mbrojtjen e të drejtave të tjera të njeriut. Nuk ka vend të lirë, nuk ka demokraci pa një garantim të gjerë të së drejtës për lirinë e shprehjes, e garantuar kjo nëpërmjet instrumenteve ligjore të shtetit të së drejtës”<sup>2</sup>.

## Mbrojtja e lirisë së shprehjes dhe dinjitetit të njeriut në legjislacionin shqiptar

Por një nga të drejtat e tjera të njeriut, që çënohet drejtpërdrejtë nga liria e shprehjes, është pikërisht dinjiteti i njeriut, edhe ky ashtu si liria e shprehjes po aq i garantuar nga instrumentat ligjorë të shtetit tonë të së drejtës (Kushtetuta dhe Kodi Penal), si dhe Konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti ynë. Kështu, Kushtetuta jonë, në nenin 3 të saj, ndër të tjera shprehet: “...dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij..., janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë ato. Po kështu, mbrojtja e dinjitetit përbën edhe një nga parimet e Kodit tonë Penal, i cili në zbatim edhe të Kushtetutës, në nenin 1/b të tij thekson: “Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë... dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij...”.

Megjithëse, si Kushtetuta ashtu edhe Kodi Penal, përmend shprehimisht vetëm termin “dinjitet”, duhet sqaruar se nderi, respektimi i të cilit përbën objektin e mbrojtjes të

---

\* Kandidat për doktoraturë, Lektor i të Drejtës Penale, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Jopublik “Luarasi”, Tiranë, Shqipëri.

<sup>1</sup> V.K.M. nr. 262, datë 4.5.2007 Për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në datë 9.5.2007 me nr. prot. 1713/1, i cili ia ka kaluar për veprim drejtorive të tij juridike dhe të seancave në datë 11.05.07 me nr. prot. 1450.

<sup>2</sup> Po aty.

veprave penale të fyerjes dhe shpifjes, është pjesë e këtij dinjiteti, i cili bazohet dhe rrjedh prej tij. Me këtë rast, saktësojmë edhe objektin real të këtyre veprave, i cili nuk është “ndjenja e dinjitetit personit”, sipas doktrinës sonë<sup>3</sup>, por nderi i personit; sepse ndjenja përbën diçka subjektive, kurse e drejta synon të mbrojë vlerën e vërtetë të personit dhe jo siç e percepton njëri apo tjetri<sup>4</sup>. Kurse dinjiteti është shumë i përgjithshëm si objekt, sepse ai çenohet edhe nga veprat kundër jetës private të personit<sup>5</sup>, krimet seksuale<sup>6</sup> etj.

Pra, dinjiteti dhe nderi i personit duhen mbrojtur po aq sa edhe liria e shprehjes dhe depenalizimi i fyerjes dhe shpifjes do të nënkuptonte një hierarki të drejtash, e cila parimisht është e palegjitimuar. Në mbrojtje të këtij boshllëku, relacioni përkatës shprehet: “Natyrisht, heqja nga Kodi Penal i dispozitave të sipërpërmendura nuk e lë pa mbrojtje qytetarin shqiptar, në raport me sulmet e pandershme mbi personalitetin dhe reputacionin e tij. Ndryshimet e propozuara në këtë projektligj janë të ndërthurura me ndryshimet e propozuara në Kodin Civil, të cilat, duke saktësuar dhe përmirësuar institutin e dëmit moral, garantojnë një mbrojtje mëse të mjaftueshme të dinjitetit dhe reputacionit të individit”.<sup>7</sup>

Por, në nenin 3 të Kushtetutës, ndër të tjera thuhet, se “dinjiteti (dhe nderi, si pjesë përbërëse e tij) përbën bazën e shtetit...” dhe kjo nënkupton, se këto vlera përbëjnë të mira juridike aq të rëndësishme dhe ekzistenciale për jetën e njeriut, sa që mbrojtja penale e tyre nuk mund të kompensohet me një zhdëmtim dëmi moral në bazë të Kodit Civil. Kujtojmë se në sistemin e së drejtës, veprat penale dhe dënimet përkatëse jepen pikërisht për të mbrojtur ato vlera, të cilat për nga rëndësia, janë nga më thelbësoret dhe jetiket për individin, shtetin dhe shoqërinë.

---

<sup>3</sup> Ismet Elezi, E drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Tiranë 2005, fq. 155; Komentari i Kodit Penal të vitit 1977, fq. 453; Drejtësia Popullore, Nr.3/1982; Komentari i Kodit Penal të R.P.SH., Pjesë e Posaçme, Vëllimi I, Tiranë 1964, fq. 186.

<sup>4</sup> Udhëzim i Plenumit të Gjykatës së Lartë Nr. 1, datë 19.12.1982 “Mbi veprat penale të fyerjes, të shpifjes dhe të rrahjes”; Ismet Elezi, E drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Tiranë 2005, fq. 155.

<sup>5</sup> Neni 121 KP “Ndërrhyrje të padrejta në jetën private”; neni 122 KP “Përhapja e sekreteve vetjake”; neni 123 KP “Pengimi ose shkelja e fshehtësisë së korrespondencës”.

<sup>6</sup> Nenet 100-108 KP.

<sup>7</sup> Po aty.

Për të ndihmuar analizën, le të bëjmë një paralelizëm me kundërvajtjet penale të rrahjes (neni 90 KP) dhe plagosjes së lehtë me dashje (neni 89 KP). Pikërisht, shpifjet dhe fyerjet nuk mund t'i quajmë gjë tjetër, përveçse përkatësisht plagosje të lehta dhe rrahje “shpirtërore”; për të mos thënë, që në aspektin e rrezikshmërisë shoqërore, si një ndër kriteret bazë për të përcaktuar nëse një sjellje e dëmshme do të klasifikohet si vepër penale apo jo (kundërvajtje administrative etj.), janë shumë më të rënda se rrahja dhe plagosja e lehtë, pasojat e të cilave zhduken me kalimin e ditëve, kurse ato të fyerjeve, dhe sidomos shpifjeve, mund të ngelen për tërë jetën. E megjithatë, rrahja dhe plagosja e lehtë nuk janë depenalizuar nga Kodi Penal, siç kërkohet të bëhet me fyerjen dhe shpifjen.

Nga ana tjetër, instituti i dëmit moral duhet të aplikohet për cënime të tjera të personalitetit, të papenalizuara nga Kodi Penal. Kështu, në një rast i akuzuari B.S. ka vajtur në banesën e të dëmtuarës akuzuese L.M. Pasi është futur në banesë, i akuzuari e ka puthur në faqe të dëmtuarën dhe pastaj ka tentuar ta prekte me dorë edhe në pjesë të tjera të trupit<sup>8</sup>.

Duhet theksuar që, veprimet e pamoralshme me natyrë seksuale nuk përmbajnë në vetvete automatikisht edhe një fyerje për personin e dëmtuar, sepse fyerja konsiston në transmetimin e një zhvlerësimi për tjetrin. Në këtë rast, autori nuk shpreh gjykim negativ për pavlefshmërinë e të dëmtuarës, por vetëm dashjen për përmbushjen e një dëshire seksuale, gjë që vërteton mungesën e dashjes (anës subjektive) për ta fyer atë. Madje, edhe sikur autori ta ketë parashikuar mundësinë e poshtërimit të tjetrit nëpërmjet sjelljes së tij, përsëri, sipas ligjit tonë penal, nuk do të kishim fyerje, sepse për të kërkohet dashja e drejtpërdrejtë (neni 119 KP: „Fyerja e qëllimshme e personit...“). Vërtetë që autori i ka shkaktuar asaj vuajtje shpirtërore, por kjo nuk do të thotë se ai e fyer vetvetiu atë, sepse cënimi i nderit nuk është i njëjtë me ndjenjën e turpfit. Pra, fyerja nuk duhet kthyer në një vepër penale „rrjetë“ për sjellje ende të papenalizuara, vetëm e vetëm për shkak të imoralitetit të tyre. Në çdo rast duhet provuar në mënyrë të pavarur, nëse autori,

---

<sup>8</sup> Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Vendim nr. 469, datë 22.04.2005.

nëpërmjet sjelljes së tij, shpreh poshtërim ndaj të dëmtuarit, duke e trajtuar si një qenie të dorës së dytë apo duke i etiketuar një cilësi negative.

Pra, pikërisht këto veprime përbëjnë cënim të personalitetit të tjetrit, cënim i cili duhet të zgjidhet në rrugë civile, nëpërmjet kërimit të kompensimit të dëmit moral (neni 625 KC). Përndryshe, i takon ligjvënësit që të vendosë penalizimin edhe të sjelljeve të tilla (“ngacmimet seksuale”), të cilat janë poshtë pragut të veprave seksuale apo atyre kundër moralit të parashikuara nga Kodi ynë Penal. Saktësojmë, se edhe termi “reputacion” i përdorur në relacion, nuk është gjë tjetër veçse aspekti “social” i të njëjtit nder të individit, d.m.th. vlerësimi i merituar (objektiv) që kanë të tjerët për të, krahas atij që vetë ai ka për veten e tij (nderi “personal”).

### **Praktika e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut**

Një argument tjetër që i kundërvihet depenalizimit të fyerjes dhe shpifjes, janë edhe aktet ndërkombëtare (Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut), praktika dhe udhëzimet e vetë Gjykatës së Strasburgut, si dhe standardet europiane, të cilat relacioni kërkon të mbahen parasysh në këtë nisëm legjislativ.<sup>9</sup> Kështu, përsa i përket Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në nenin 10/2 të saj për Lirinë e Shprehjes, ajo shprehet: *“Ushtrimi i këtyre lirive (lirisë së shprehjes), që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t’u nënshtrohet disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji, të cilat, në një shoqëri demokratike, përbëjnë masa të nevojshme për sigurimin kombëtar, integritetin territorial ose sigurimin publik, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e informatave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor”*. Pra, vetë Konventa pranon që, për mbrojtjen e dinjitetit, liria e shprehjes mund t’u nënshtrohet kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara nga ligji; dhe veprat penale për fyerje dhe shpifje bashkë me dënimet përkatëse, nuk janë gjë tjetër veçse masa të parashikuara nga ligji për mbrojtjen e dinjitetit të të tjerëve.

---

<sup>9</sup> Po aty.

Vërtet që Gjykata i mëshon mosaplikimit të dënimeve me burg, për shkak të efektit të një lloj auto-censure për gazetarët, por nga ana tjetër ky lloj dënimi mund të ketë edhe rol parandalues ndaj abuzimeve të qëllimshme me lirinë e shprehjes në dëm të nderit dhe reputacionit të individëve. Pra, në varësi të nivelit të emancipimit dhe profesionalizmit në një shoqëri dhe situatë të caktuar, i përket shtetit që të vendosë për uljen e këtij dënimi apo heqjen e tij dhe lënien vetëm të dënimit me gjobë. Fakti që Gjykata e Strasburgut e toleron dënimin me gjobë<sup>10</sup>, por thjesht tërheq vëmendjen për proporcionalitetin e tij, tregon se ajo i pranon veprat penale përkatëse si masa legjitime në mbrojtje të nderit dhe dinjitetit të personit.

Bazuar në paragrafin e dytë të nenit 10 të Konventës, Gjykata e Strasburgut thekson se, autoritetet vendase mund të ndërhyjnë në ushtrimin e lirisë së shprehjes kur plotësohen 3 kushte së bashku:

- 1) ndërhyrja parashikohet me ligj (parimi i ligjshmërisë)
- 2) ndërhyrja ka si qëllim të mbrojtë një ose më shumë nga interesat ose të drejtat e parashikuara në këtë paragraf (parimi legjitimitetit)
- 3) ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike (parimi i proporcionalitetit)

Kushti i parë ka të bëjë me parimin e ligjshmërisë ose mosdënimin pa ligj (neni 2 KP), sipas të cilit “askush nuk mund të dënohet penalisht për një vepër që më parë nuk është parashikuar shprehimisht në ligj si krim ose kundërvajtje penale”. Kushti i dytë lidhet me legjitimitetin e të gjithë figurave të tjera të fyerjes ose shpifjes, për të cilat nisma legjislative propozon shfuqizimin nga Kodi Penal.<sup>11</sup> Konkretisht, krahas fyerjes (119 KP) dhe shpifjes (120 KP) së thjeshtë, bëhet fjalë për “Fyerjen ndaj përfaqësuesve të shteteve të huaja” (neni 227 KP), “Veprimet fyese ndaj himnit e flamurit” (neni 229 KP), “Kundërshtimi i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik” (neni 235 KP), “Fyerja për shkak të detyrës” (neni 239 KP), “Shpifja për shkak të detyrës”

---

<sup>10</sup> Tammer kundër Estonisë; Open Door and Dublin Well Woman Centre kundër Irlandës, 1992.

<sup>11</sup> Neni 1 i Projektligjit.

(neni 240 KP), “Shpifja ndaj Presidentit të Republikës” (neni 241 KP) dhe “Fyerja ndaj gjyqtarit” (neni 318 KP).

Lidhur me nenet 227 dhe 229 KP ka dy pikëpamje:

a) pikëpamja e parë, që mbron edhe qeveria në relacionin e saj, është mungesa e legjitimitetit të këtyre veprave, për shkak të objektit juridik që ato mbrojnë. Konkretisht, këto vepra janë parashikuar për të mbrojtur marrëdhëniet me shtetet e tjera dhe një interes (qëllim i tillë) nuk është parashikuar nga paragrafi i dytë i Konventës. Natyrisht, ky shfuqizim nuk do ta linte pa mbrojtje nderin dhe dinjitetin e subjektit të huaj, pasi autori mund të përgjigjet për fyerje të thjeshtë (neni 119 KP), në lidhje me rrethanën rënduese të pikës f) të nenit 50 KP (kur vepra është drejtuar ndaj përfaqësuesve të shteteve të tjera). Megjithëse, rrethana rënduese e dënimit do të binte përsëri ndesh me udhëzimet e Gjykatës së Strasburgut për mosprivilegjim të subjekteve të huaja<sup>12</sup> (shih më poshtë).

b) pikëpamja e dytë nis nga paralelizmi i nenit 229 KP me nenin 268 KP (Poshtërimi i Republikës dhe simboleve të saj), për të cilin qeveria propozon jo shfuqizimin, si për nenin 229, por vetëm ndryshimin e tij.<sup>13</sup> Ekzistenca e kësaj vepre është legjitime, sepse qëllimi i parashikimit të saj, mbrojtja e rendit dhe sigurisë publike, është një interes i parashikuar në paragrafin e dytë të Konventës. Nisur nga ky fakt, kjo pikëpamje bën edhe një interpretim të zgjeruar të legjitimitetit të nenit 227 dhe 229 KP, sipas të cilës, mbrojtja e marrëdhënieve me shtetet e tjera duhet parë në kuptimin e sigurisë kombëtare, qëllim ky i parashikuar nga ky paragraf, dhe renditja e këtyre veprave në këtë kre të Kodit Penal është bërë thjesht formalisht, për shkak të subjekteve të huaja të cilat ato çenojnë. Ky interpretim do të hidhte poshtë edhe përpjekjen e relacionit për të argumentuar shfuqizimin e nenit 227, me arsyetimin, se ai kufizon një formë të lirisë së shprehjes, përmes protestës<sup>14</sup>, ndërkohë që ky argumentim do të vlente edhe për nenin 268, i cili nuk shfuqizohet. Vërtet që veprimet kundër simboleve të një shteti, siç janë himni dhe flamuri, janë pjesë e asaj që njihet si e drejta e protestës simbolike, por kur kjo protestë e tejkalon qëllimin në formë dhe përmbajtje, atëherë ajo mund të përbëjë një rrezik serioz për paqen dhe sigurinë publike.

<sup>12</sup> Colombani kundër Francës.

<sup>13</sup> Neni 2 i Projektligjit.

<sup>14</sup> Po aty.

Edhe heqja, ndër të tjera, e “himnit”, në ndryshimin e propozuar në projektligj për nenin 268 KP nuk është e justifikuar, sepse himni, po aq sa stema dhe flamuri i Republikës, përbën një simbol të qenësishëm të përfaqësimit të një shteti. Relacioni ka lënë të paargumentuar shfuqizimet e propozuara për nenet 239, 240, 241 KP, të cilat janë vepra kundër autoritetit të shtetit. Për këtë na ndihmon përsëri paralelizmi me nenin 318 KP (fyerja gjyqtarit), për të cilin propozohet gjithashtu shfuqizimi. Kjo vepër është parashikuar për të mbrojtur autoritetin e pushtetit gjyqësor, i cili përbën një interes legjitim të parashikuar nga paragrafi i dytë i Konventës. Por, autoriteti gjyqësor nuk është veçse pjesë e autoritetit shtetëror që mbrojnë veprat e mësipërme dhe i sistemuar formalisht në një kre më vete, për shkak të ndarjes së pushteteve; prandaj, depenalizimi i fyerjes dhe shpifjes për shkak të detyrës, si dhe i shpifjes ndaj Presidentit të Republikës, janë gjithashtu të pajustificuara.

Për të mos krijuar një privilegj formal për zyrtarët apo gjyqtarët, mirë do të ishte që dispozitat përkatëse të saktësoheshin me formulimin “...kur fyerja apo shpifja përbën rrezik serioz për ushtrimin e detyrës” dhe të mos bëhej fjalë për çfarëdolloj zyrtari apo gjyqtari, por për ata që ushtrojnë detyrën në funksione të rëndësishme kushtetuese. Ky privilegj, i cili bie ndesh edhe me parimin e barazisë para ligjit, vihet re sidomos në dënimet e veprave përkatëse, ku p.sh. “fyerja për shkak të detyrës (paragrafi i parë)” dënohet më shumë se “fyerja e thjeshtë”; apo “shpifja ndaj Presidentit të Republikës”, “fyerja e gjyqtarit” dhe “fyerja ndaj përfaqësuesve të shteteve të huaja” përbëjnë krime, ndryshe nga fyerja apo shpifja e thjeshtë, të cilat janë kundërvajtje penale.

Kushti i tretë i “proporcionalitetit” argumenton pikërisht konkluzionin, se asnjëra nga të drejtat, as ajo për respektimin e nderit dhe dinjitetit dhe as ajo për t’u shprehur (liria e shprehjes), nuk duhet të kenë formalisht prioritet ndaj njëra-tjetrës, pasi si Konventa ashtu edhe Kushtetuta (neni 3: ...dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij...) i mbron njëllëj ato. Por, rast pas rasti, duhet analizuar (baraspeshuar), se cila prej këtyre vlerave është më e rëndësishme në situatën konkrete. Kështu, nqs abuzohet me lirinë e shprehjes, atëherë prioritet merr nderi dhe dinjiteti i njeriut, për cënimin e të cilave janë parashikuar



dhe dënimet përkatëse në Kodin Penal. Nga ana tjetër, megjithëse nëpërmjet shprehjes mund të cënohet praktikisht nderi i personit tjetër, nqs ajo bëhet për të mbrojtur një interes të parashikuar nga paragrafi i dytë i Konventës, atëherë autori do të përjashtohet nga përgjegjësia penale për fyerje. Për këtë përjashtim nuk ka nevojë të depenalizohen veprat e fyerjes dhe të shpifjes, pasi vetë Kodi Penal nëpërmjet nenit 21 të tij (Ushtrimi i një të drejte apo përmbushja e detyrës) shprehet: “Nuk ka përgjegjësi penale personi që vepron për të ushtruar të drejta...” dhe në këtë rast ushtrohet e drejta e shprehjes në funksion të mbrojtjes të një interesi tjetër legjitim.

Gjykata e Strasburgut ka zhvilluar një jurisprudencë mjaft të pasur në këtë drejtim, duke aprovuar mbrojtjen e lartë që i duhet bërë lirisë së shprehjes, dhe në veçanti shtypit në misionin e tij si ofrues informacioni dhe roje publike. Vendi i privilegjuar i medias vjen si rrjedhojë e pikëpamjes së Gjykatës për rolin qendror të shprehjes politike në një shoqëri demokratike, si në lidhje me procesin elektoral, ashtu edhe me problemet e përditshme me interes publik.

Përsa i përket gjuhës, Gjykata ka pranuar si kritikën e ashpra dhe të vrazhda, ashtu edhe shprehjet e rënduara me kuptime figurative, duke qenë se këto të fundit kanë avantazhin e tërheqjes së vëmendjes për çështjet në diskutim. Kështu, në çështjen *Schwabe*, Komisioni duke iu referuar kufizimeve eventuale gjuhësore theksoi: „Në një kontribut sado të vogël në një debat mbi qëndrimet e politikanëve dhe moralit të tyre politik, jo çdo fjalë mund të peshohet, për të përjashtuar çdo lloj mundësie keqkuptimi“. Ose në çështjen *Dalban*, Gjykata duke i dhënë lirisë së shtypit më shumë hapësirë, u shpreh: „Liria gazetareske mbulon gjithashtu edhe replika të mundshme deri në një shkallë ekzagjerimi, madje edhe provokimi“.

Gjykata mbështet gjithashtu pikëpamjen se, politikanët duhet të tregojnë më shumë tolerancë në lidhje me kritikën e medias. Gjykata shpjegon edhe arsyen: „...liria e debatit politik qëndron në thelbin e konceptit të një shoqërie demokratike. Kufijtë e kritikizmit të lejueshëm duhet të jenë më të gjerë përsa i përket një politikani, sesa për një individ

privat, sepse ndryshe nga ky i fundit, i pari është në mënyrë të paevitueshme më i ekspozuar“.

### **Konkluzione**

Meqë liria e shprehjes i referohet si dhënies së informacionit, ashtu edhe dhënies së mendimeve, merr rëndësi dallimi që ka bërë Gjykata midis fakteve (informacionit) dhe gjykimeve vlerësuese (opinioneve, mendimeve): Ndërsa opinionet janë pikëpamje ose vlerësime personale të një ngjarje ose situatë dhe nuk janë të perceptueshme si prova për të qenë të vërteta ose të pavërteta, faktet mbi të cilat bazohen opinionet, janë të mundshme për t’u provuar si të vërteta apo të pavërteta. Në këtë kuptim, bashkë me informacionin ose të dhënat që mund të verifikohen, nga neni 10 janë të mbrojtura edhe opinionet, kritikrat ose spekulimet, që mund të mos provohen si të vërteta. Dallimi midis fakteve dhe gjykimeve (opinioneve), si dhe ndalimi i kërkesës për prova në lidhje me këto gjykime, është i domosdoshëm në sistemet ligjore kombëtare që e parashtrojnë këtë si kusht për veprën e “fyerjes”. Edhe në lidhje me faktet, Gjykata ka njohur mbrojtjen në bazë të qëllimit të mirë, duke i lënë medias një hapësirë ku mund të tolerohen gabimet. Në këtë kontekst, qëllimi i mirë (mirëbesimi) nuk duhet t’i nënshtrohet ndonjë kushti për provë dhe kjo liri e shtypit merr rëndësi në rastet e botimit të „thashethemeve“ apo pretendimeve, të cilat gazetarët nuk kanë mundësi t’i provojnë<sup>15</sup>

Mbrojtja në mirëbesim, duhet të pranohet për shpifjet, të cilat kryesisht kanë lidhje me fakte. Nëse në kohën e botimit, gazetari do kishte arsye të mjaftueshme për të besuar, se një pjesë e veçantë e informacionit ishte e vërtetë, ai nuk duhet të sanksionohet. Lajmi përbën një komoditet që zhduket shpejt dhe të vonosh botimin e tij, madje edhe për një periudhë të shkurtër, mund t’i heqë atij të gjithë vlerën dhe interesin<sup>16</sup>. Për këtë arsye, një gazetari duhet t’i kërkohej të bëjë kontrollin (verifikimin) e duhur dhe të pranojë në mirëbesim vërtetësinë e lajmit. Argumenti në lidhje me këtë element, ka të bëjë me mungesën e qëllimit nga gazetari për të shpifur për të dëmtuarin e pretenduar. Përsa kohë që gazetari beson se informacioni është i vërtetë, një qëllim i tillë mungon dhe kështu,

---

<sup>15</sup> Thorgeirson kundër Islandës, 1992.

<sup>16</sup> Sunday Times (2) kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1991.

qëndrimi i gazetarit nuk duhet të sanksionohet në bazë të klauzolave që ndalojnë shpifjet e qëllimshme, të parashikuara në legjislacionin penal.

### **Bibliografia**

- 1) V.K.M. nr. 262, datë 4.5.2007 Për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”, përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në datë 9.5.2007 me nr. prot. 1713/1, i cili ia ka kaluar për veprim drejtorive të tij juridike dhe të seancave në datë 11.05.07 me nr. prot. 1450;
- 2) Ismet Elezi, E drejta Penale, Pjesa e Posaçme, Tiranë 2005;
- 3) Komentari i Kodit Penal të vitit 1977;
- 4) Drejtësia Popullore, 1982;
- 5) Komentari i Kodit Penal të R.P.SH., Pjesë e Posaçme, Vëllimi I, Tiranë 1964;
- 6) Udhëzim i Plenumit të Gjykatës së Lartë Nr. 1, datë 19.12.1982 “Mbi veprat penale të fyerjes, të shpifjes dhe të rrahjes”;
- 7) Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, Vendim nr. 469, datë 22.04.2005
- 8) Tammer kundër Estonisë;
- 9) Open Door and Dublin Well Woman Centre kundër Irlandës, 1992;
- 10) Colombani kundër Francës;
- 11) Thorgeirson kundër Islandës, 1992;
- 12) Sunday Times (2) kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1991.
- 13) Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (i azhornuar);
- 14) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- 15) Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut;